



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 87 prot.

Kamëz, më 17.06.2022

V E N D I M
Nr. 74.Datë 17/06 2022
M B I

“ NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.06.2022, pasi mori në shqyrtim kërkesën për ndryshimin e emërtimit të rrugës nga **“Vangjel Koca”** në **“Prek Mani”**, datë 22.02.2022 në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I :

1. Emërtimin **“Prek Mani”** rrugës sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Drejtorja e Shërbimeve Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen KOLDASHI